

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Med
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** "N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censu
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... ikimit audioviziv apo ndor
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 9

Dërbajtja

Hyrja	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës	09
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve.....	15
SEKSIONI III	
Ankesa me objekt jashtë juridiksionit të Ama-s	23
SEKSIONI IV	
Ankesa me objekt të ndryshëm	31

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Buletini nr.9 i Këshillit të Ankesave, si pjesë e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" vjen me një aspekt të shtuar të cënimit të dinjitetit të individit përmes gjuhës së urrejtjes. Stereotipet me bazë gjinore përbëjnë një ndër cënimet më të shpeshta të etikës së informacionit dhe komunikimit në media ndaj edhe vëmendja e shtuar ndaj tyre nuk është vetëm një detyrim për përmbushjen e kërkesave ligjore, por më së shumti i shërben lirisë së shprehjes, duke respektuar lirinë dhe dinjitetin e tjetrit.

Një prej konkluzioneve të Këshillit të Ankesave, të përmbledhur në këtë buletin, i referohet lirisë së medias, si një gur themeli për një shoqëri demokratike si edhe si një mjet i pazëvendësueshëm për t'i siguruar çdokujt mundësinë e shprehjes së opinionit të tij lirshëm, por pa shkelur privatësinë, pa denigruar apo fyer dhe pa përdorur shprehje banale e diskriminuese, të cilat bien në kundërshtim me sistemin tradicional të vlerave.

Fenomeni i stereotiopeve përballet me norma dhe sanksione, të parashikuara nga Kodi i Transmetimit, i cili buron prej ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Një prej dispozitave më të rëndësishme të këtij ligji ligj përcakton se ofruesit e shërbimeve audiovizive "nuk transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinore, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi". Edhe sipas njërit prej parimeve themelore të Kodit të Transmetimit, transmetimet audiovizive "nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve". Ankesat e trajtuara në këtë buletin kanë në fokus raste të diskriminimeve fetare, gjinore dhe të tjera, të lidhura me orientimin seksual, përkitazi pjesëtarëve të komunitetit LGBT si një detyrim që rrjedh nga Ligji për Mediat Audiovizive dhe Kodi i Transmetimit.

Duke e konsideruar shumë të rëndësishëm parimin e mosdiskriminimit, Këshilli i Ankesave ka ndërvepruar me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave jo vetëm përmes tërheqjes së vëmendjes ndaj OSHMA-së përkatëse për shkelje të tilla, por edhe përmes sensibilizimit dhe rikujtesës së parimeve bazë të Kodit të Transmetimit si detyrim ligjor.

Kodi i Transmetimit i AMA-s, si një akt nënligjor, i ka të përcaktuara në mënyrë eksplicite normat, parimet dhe kërkesat për operatorët audiovizivë, si mjete të pavarura informacioni dhe platforma mediatike të zhvillimeve publike, politike dhe shoqërore që kanë qëllim informimin, argëtimin dhe edukimin.

Këshilli i Ankesave edhe në periudhën përkatëse ka vijuar takimet me aktorë të ndryshëm të shoqërisë, për t'u shpjeguar rolin dhe detyrat e tij, në mbrojtje të parimeve themelore të sanksionuara nga Kodi i Transmetimit. Çmojmë se përpjekje të tilla kanë shërbyer për të sensibilizuar shoqërinë që të adresojë ankesat dhe shqetësimet e saj mbi përmbajtjet audiovizive në vend. Cënimi i të drejtave të të miturve apo cënimi i rregullave të etikës dhe dinjitetit vijon të mbetet në fokusin e ankesave të trajtuara edhe në këtë buletin.

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën **"Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit"**, plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet **Buletini i Këshillit të Ankesave**. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.



Ankesa me
objekt
"Cënimin e
rregullave
të etikës
dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:

Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Report TV	Edicione informative	02, 03.07.2020
Syri TV	Edicione informative	02, 04, 06, 07.2020
Top Channel	Edicione informative	03, 06, 08.07.2020
TV Klan	Edicione informative	02, 03, 04, 05, 06, 07.07.2020
News 24	Emisioni "Real Story"	02.07.2020
	Edicione informative	03.07.2020
	Edicione informative	06.07.2020
Abc News	Edicione informative	
	Emisioni "Provokacia"	02, 03, 04, 05, 06, 07.07.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave i është drejtuar me shkrim Organizata Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri, e cila ka bërë një ankesë për transmetimet e disa operatorëve audiovizive, konkretisht: edicionet informative të "Report TV", të transmetuara në datat 02, 03.07.2020; edicionet informative të "Syri TV", të transmetuara në datat 02, 04, 06, 07.2020; edicionet informative të televizionit "Top Channel", të transmetuara në datat 03, 06, 08.07.2020; edicionet informative të televizionit "Klan", të transmetuara në datat 02, 03, 04, 05, 06, 07.07.2020; emisionin "Real Story", të televizionit "News 24", të transmetuar në 02.07.2020 si dhe edicionet informative, të transmetuara në datat 03 dhe 06 korrik 2020; edicionet informative të televizionit "Abc News" dhe emisionin "Provokacia", transmetuar në datat 02, 03, 04, 05, 06, 07.07.2020. Ankesa ngrihet mbi pretendimin se informacionet, që kanë qarkulluar në edicionet informative dhe emisionet e lartpërmendura mbi ngjarjen e ndodhur më 02.07.2020, në familjen Josifi, e cilësuar si pjesëtarë të Dëshmitarëve të Jehovahit, nuk janë të vërteta. Konkretisht përfaqësuesit e organizatës pretendonin në ankesën e tyre, se në kronikat e lajmeve dhe programet tele-

vizive kishin qarkulluar "akuza të pabaza", "të pavërteta", "shpifje" dhe qëndrime "diskriminuese ndaj këtij grupimi fetar". Ndaj ata kërkonin ndërprerjen e qarkullimit të këtyre materialeve si dhe publikimin e një letre përgënjeshtroese nga ana e këtyre operatorëve audiovizivë.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave monitoroi përmbajtjet audiovizive përkatëse dhe konkludoi, se çështjet e trajtuara përbënin interes të lartë publik për shkak të humbjes së jetëve njerëzore, ndërsa raportimet apo informacionet kishin për burim dëshmi të ndryshme. Gjithashtu u konstatua, se raportimet audiovizive kishin transmetuar edhe pretendimet e përfaqësuesve të organizatës në lidhje me ngjarjen, ku ata përjashtonin çdo mundësi, që viktimat të ishin anëtarë të Dëshmitarëve të Jehovahit. Në këto kushte, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vlerësoi vendimin e operatorit për ndalimin e përmbajtjeve të kundërshtuara nga ana e organizatës dhe e konsideroi të ezauruar të drejtën e përgjigjes nga ana e operatorëve.

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit parashikojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat operatorët audiovizive

duhet të respektojnë të drejtën e përgjigjes, veçanërisht

isht në rastet kur një palë nuk i është dhënë asnjë mundësi të japë pretendimet e veta. Konkretisht, referuar nenit 53, pika 13, germa b, ë dhe f, parashikohet se;

"13. Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe s'ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;

ë) transmetimi i kundërshtuar përmban një thënie apo deklaram të personit të prekur, të tillë që konsiderohet i barasvlershëm me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e transmetimit;

f) një korrigjim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i prekur".

Përsa më sipër, Këshilli i Ankesave gjykoi se kërkesa e ankuesit për të drejtën e përgjigjes ishte përmbushur sipas parashikimeve ligjore të Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga: **S.N**

Subjekti audioviziv

Top Channel

Programi

**Shiko kush luan
Për'puthen**

Data

09.08.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave i është drejtuar ankuesja S.N., e cila pretendonte se në emisionin "Shiko kush luan", transmetuar në datën 24.10.2020, në televizionin "Top Channel", personaliteti i femrës është denigruar përmes ekspozimit të trupit femëror. Ankuesja pretendonte gjithashtu, se edhe në emisionin "Për'puthen", transmetuar në datën 09.08.2020, janë adresuar deklarata bullizuese ndaj një konkurrenteje.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen e emisionit "Shiko kush luan" dhe pavarësisht natyrës argëtuese të emisionit, konstatoi, se zgjedhja grafike e përdorur, në të cilën, një trup femre qëllon në pjesë private/intime, denigron figurën e femrës.

Për sa më sipër, vijnë në vështrim dispozitat e mëposhtme: ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton... personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (neni 4, pika 1, germa b).

Ligji i sipërcituar përcakton edhe detyrimet që kanë OSHMA-të në veprimtarinë e tyre. Neni 33, në pikën 1, germa ç) dhe d) sanksionon përkatësisht: "të mos çenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut" dhe "të respektojë rregullat e etikës e moralit publik, dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".

Këshilli i Ankesave verifikoi përmbajtjen audio-

vizive përkatëse të emisionit "Për'puthen" dhe konstatoi, se deklaratat bullizuese në adresë të një konkurrenteje përbënin shkelje të Kodit të Transmetimit, në pikën 4.8, ku sanksionohet se transmetimet "nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, moshë, ngjyra, etnia, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër", si dhe "të respektojnë interesin më të lartë të fëmijëve", (Seksioni 1, Parimet themelore).

Bazuar në sa më sipër, AMA tërhoqi vëmendjen për shkeljen e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit" dhe kërkoi marrjen e masave edhe teknike si për të shmangur në transmetim fjalorin e papërshtatshëm ashtu edhe për vendosjen e shenjave paralajmëruese, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit në pikën 5.48 të tij.

Ankesa e paraqitur nga: **T.L**

Subjekti audioviziv

Top Channel

Programi

Fiks Fare

Data

27.10.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave i është drejtuar një ankuese, e cila pretendon se në emisionin "Fiks Fare" të datës 27.10.2020, i është çenuar dinjiteti, personaliteti dhe imazhi përmes publikimit të fakteve të pavërteta.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kësaj ankese, bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit 97/2013", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave iu drejtua me një shkresë Bordit të Shqyrtimit të Ankesave në televizionin "Top Channel", duke kërkuar dhënien e pretendimeve të ofruesit mediatik audioviziv mbi rastin.

Pas marrjes së shpjegimeve nga stafi i emisionit dhe shqyrtimit me kujdes të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit.

Emisioni "Fiks Fare", një emision investigativ-satirik, kishte transmetuar një video të realizuar me kamera të fshehtë, pasi kishte kryer më parë investigime mbi temën e trajtuar. Trajtimi i kësaj të fundit kishte qenë korrekt dhe profesional, duke respektuar normat ligjore dhe etike.

2

Ankesa me
objekt
"Cënimin e
të drejtave
të femijëve"

Ankesa e paraqitur nga: **Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Abc News"	Emisioni "Byro Politike"	08.07.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave i është drejtuar Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, përmes përfaqësueses së saj, E.R, e cila ankohet se në emisionin "Byro Politike", transmetuar në televizionin "Abc News", më datë 08.07.2020, nga të ftuarit në studio janë "përdorur shprehje diskriminuese ndaj personave me ngjyrë". Konkretisht, gjatë emisionit, një prej të ftuarve, SH.N, ishte shprehur në mënyrë të papërshtatshme, fyese dhe denigruese ndaj personave me ngjyrë, duke thënë: "shkoni e merrni tremijë bythëzinj jashtë, që të vijin këtu të numërojnë votat". Kjo shprehje solli reagimin e të ftuarit tjetër, I.K, i cili e konsideroi shprehjen me "konotacion racist", por jo reagimin e moderatores së emisionit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi përmbajtjen audiovizive dhe konstatoi shkelje të nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Referuar ligjit për mediat audiovizive, në transmetimet e tyre OSHMA-të duhet "të mos cënojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut" (neni 33, pika 1, germa ç) dhe "nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi" (neni 32, pika 4).

Kodi i Transmetimit, pika 1.5 sanksionon se "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve".

Më tej, ky Kod, në pikën 4.8 përcakton se "Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen OSHMA-së, kërkoi ndalimin e ritransmetimit të emisionit "Byro Politike", të datës 08.07.2020 si edhe editimin/korrektimin e materialit filmik në kanalin zyrtar në "YouTube".

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Klan	Film, komedi "Meet the Fockers"	09.08.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa në lidhje me transmetimin në "TV Klan" të një filmi, komedisë "Meet the Fockers", transmetuar në datën 09.08.2020, nga ora 17:49 e në vijim. Ankuesit pretendonin se filmi përmbante skena të papërshtatshme dhe fjalor të rëndë, megjithëse shfaqej në një fashë orare, ku mund të ndiqej edhe nga fëmijët.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave, konstatoi se filmi kishte fjalor të papërshtatshëm dhe disa skena erotike, që, në orarin e transmetimit, mund të ndiheshin edhe nga të miturit, duke mbartur në vetvete mundësinë e dëmtimit të zhvillimit mendor, fizik dhe moral të fëmijëve.

Bazuar në sa më sipër, AMA i rikujtoi OSHMA-së zbatimin e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, si dhe i kërkoi mbajtjen parasysh të interesit më të lartë të fëmijëve, duke garantuar, që transmetime të tilla në të ardhmen të planifikoheshin përputhur me kërkesat e Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Top Channel	Edicion Informativ Shqipëria live Ftesë në 5	13.09.2020 10.09.2020 09.09.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa në lidhje me disa formate të transmetuara në televizionin "Top Channel": ankesa e parë i referohej mundësisë së identifikimit të tërthortë të viktimës në një kronikë lajmesh, transmetuar në datën 13.09.2020, e cila përmbante intervistën e nënës së një të miture në rrethin e Pogradecit, e cila dyshohej të ishte abuzuar seksualisht. Ankesa tjetër i referohej emisionit "Shqipëria live", transmetuar në datën 10.09.2020, ku një prej të ftuarve bënte thirrje paniku lidhur me situatën e pandemisë Covid -19, me shprehje të tilla, si "...duhet të krijoni rezerva ushqimore, se këta do na mbyllin 6 muaj të tjerë në muajin tetor". Ankesa e tretë, shkante në adresë të emisionit "Ftesë në 5", transmetuar në datën 09.09.2020, ku pretendohet, se ishte përdorur fjalor banal dhe fyes midis të ftuarve.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi përmbajtjen audiovizive përkatëse, konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive. Në vendimet e veta, Këshilli i Ankesave çmoi se intervistimi i nënës së të miturës së abuzuar seksualisht në ambientet e shtëpisë së saj, bënte të mundur identifikimin e saj, duke shkelur ligjin e sipërcituar, sipas të cilit "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, person-

alitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve; (neni 4, pika b).

Publikimi i identitetit të nënës së vajzës, e cila dyshohet të jetë abuzuar seksualisht dhe i detajeve të tjera, që identifikojnë të miturën në mënyrë të tërthortë, shkel parimin e ruajtjes së privatësisë, sanksionuar edhe në Kodin e Transmetimit, në pikën 5.4 të Seksionit 5 të të cilit thuhet, se "Të dhënat e publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cënojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkollë, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit apo veprës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën".

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim edhe përmbajtjen audiovizive përkatëse të emisionit "Shqipëria live", duke konstaturuar shkelje të Kodit të Transmetimit, pasi njëri prej të ftuarve, duke bërë thirrjet e sipërcituara lidhur me situatën e pandemisë Covid -19, përveçse kishte përhapur panik në publik, kishte cënuar rëndë interesin publik.

Pika 3.5 e Kodit të Transmetimit sanksionon se "Interesi publik përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- i) Zbulimin apo ekspozimin e krimit apo të padrejtësisë serioze.
- ii) Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të sigurisë.

iii) Parandalimin e publikut nga mashtrimi me një veprim apo deklaratë të një individi apo organizate.

iv) Garantimin për të pasur akses në informacione që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Për qëllimet e këtij Kodi, interesi publik, nuk duhet të justifikojë pasaktësitë dhe spekulimet".

Megjithë ndërhyrjet e përsëritura të moderatorëve, për t'u bërë me dije të ftuarve, se po përdornin "gjuhë të papërshtatshme", Këshilli i Ankesave e gjeti me vend t'i rikujtojë OSHMA-së, se ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit ngarkon me detyrime të paanashkalueshme operatorët audiovizivë, për të mbrojtur dhe promovuar në çdo rast interesin publik dhe jo spekulimet e ndryshme.

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim edhe përmbajtjen audiovizive përkitazi emisionit "Ftesë në 5", duke konstaturuar përdorim fjalori banal dhe fyes midis të ftuarve, këngëtares Albërie Hadërgjonaj dhe përfaqësuesve të "Arkiva Shqip".

ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar sanksionon se "Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime:

d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intencën ndërmjet shtetasve;

dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën;"

Bazuar në kontaktimet e mësipërme, Këshilli i Ankesave pranë AMA tërhoqi vëmendjen e OSHMA-së, duke kërkuar respektim të dispozitave ligjore të sipërcituara në të ardhmen dhe paralajmëroi operatorin, se në rast përsëritjeje të shkeljeve të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit do të ndërmerreshin sanksionet e parashikuara me ligj.

Ankesa e paraqitur nga:

Disa ankues

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV Klan

Klanifornia

21.11.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa në lidhje me emisionin "Klanifornia", transmetuar në datën 21.11.2020, në orën 21:21. Ankuesit bënin me dije se gjatë këtij emisioni "ishte shfaqur në ekran një faqe pornografike", konkretisht emri i faqes "Brazzers", logoja e së cilës ishte shfaqur gjithashtu në ekran.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi materialin filmik, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Kodit të Transmetimit.

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcakton parimet themelore, sipas të cilave, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton... personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve". (neni 4, pika 1, germa b).

Ligji i sipërcituar përcakton edhe detyrimet që kanë OSHMA-të në veprimtarinë e tyre. Sipas Nenit 33, në pikën 1 germa ç) dhe d) sanksionohet përkatësisht: "të mos cënojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore" dhe "të respektojnë rregullat e etikës e moralit publik, dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale". Këto parime mirëpërcaktohen edhe në Kodin e Transmetimit. Sipas Seksionit 1, "Parimet themelore", që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, u kërkohet OSHMA-ve "të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe dre-

jtat themelore të njeriut, si dhe të respektojnë në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

Kodi i Transmetimit kërkon që në programe argëtuese, në rast të ndonjë sjelljeje të diskutueshme, vizuale apo zanore (fjalor apo imazh të papërshtatshëm), OSHMA-të duhet të kihet parasysh dy elementë; së pari, të bëhet kujdes që këto produkte të transmetohen pas orës 22:00 dhe së dyti, të paraprihen nga prania e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre (shenja paralajmëruese).

Bazuar në sa më sipër, AMA tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit si dhe i kërkoi OSHMA-së marrjen e masave të duhura teknike për vendosjen e shenjave paralajmëruese, bazuar në përcaktimet e Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:

Qendra e bashkuar Pro Kauzës LGBT-PRO-LGBT, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV Klan

Klanifornia

19.10.2019
02.11.2019
31.12.2019

1. Përmbledhje e Ankesës

Qendra e bashkuar Pro Kauzës LGBT-PRO-LGBT, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT ka bërë një ankesë ndaj emisionit "Klanifornia", transmetuar në televizionin "Klan". Ankesa drejtohej ndaj një skeçi specifik të transmetuar në datat 19.10.2019, 02.11.2019 dhe 31.12.2019. Në ankesën e tyre, pretendohet se personazhi i quajtur "Minion" paraqiste një stereotipizim të dëmshëm, me nota të theksuara urretjeje, përbuzjeje dhe homofobie. Ankuesit pretendonin, se përmbajtja e skeçit mund të rezultonte e dëmshme për fëmijët dhe të miturit, që i përka-sin komunitetit LGBT apo që kanë sjellje/qëndrime të ndryshme nga strukturat shoqërore, të ndërtuara mbi heteronormativitet.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes materialin filmik të transmetuara në datat 19 tetor, 2 nëntor dhe 31 dhjetor 2019 dhe konstatoi se nuk janë në kushtet e një përmbajtjeje audiovizive, që mund të nxiste urretjen, intolerancën, diskriminim ose që mund të justifikonte dhunë ndërmjet shtetasve. Referuar skeçit në fjalë, Këshilli i Ankesave konstatoi, se nuk përbënte rast stereotipizimi të dëmshëm, me nota homofobie. Përkitazi kësaj çështjeje, Këshilli i Ankesave vuri në dukje, se prodhimet e humorit janë krijime artistike dhe se çdo ndërhyrje ndaj tyre duhet të jetë e kujdesshme, pasi mund të perceptohet si censurë dhe kufizim i lirisë së shprehjes. Një nga parimet e Kodit të Transmetimit, konkretisht pika 1.14, përcakton se "Operatorët e shërbimit mediatic audioviziv duhet

të jenë të hapur ndaj ideve, opinioneve, tendencave e kahjeve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare". Në rastin konkret, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shprehje fyese, përbuzëse, diskriminuese apo gjuhë urretjeje ndaj komunitetit LGBT, që mund të krijojnë kushte për stereotipizim të dëmshëm.

3

Ankesa me
objekt
jashtë
juridiksionit
të ANA-s

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gazeta "Shqip"	Artikull	09.08.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave ka marrë një ankesë nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur me shkrimin "Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) heton zbulimin e personit që ka publikuar listën", publikuar në gazetën "Shqip", më datë 09.08.2020. Sipas ankuesit, AISM është institucion që mbështet Autoritetin e Drejtimit të Komandimit të Forcave të Armatosura me inteligjencën në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, në përmbushje të misionit të tyre kushtetues dhe si i tillë, nuk ka mision hetimi. Për rrjedhojë, ankuesi pretendonte se informacioni i grumbulluar nga kjo agjenci ishte sensitiv dhe duhej trajtuar si i tillë nga çdo person fizik apo juridik, përfshirë dhe shtypin shqiptar. Sipas tij, informacionet e publikuara në artikull ishin të pavërteta, ndaj duheshin trajtuar me masat përkatëse.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s pasi shqyrtoi ankesën ndaj gazetës "Shqip", konstatoi se ankesa ishte jashtë objektit të punës së AMA-s. Neni 2 i ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "Fusha e zbatimit", përcakton se "ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Në kuptimin e përkufizimeve në ligjin e sipërcituar, "Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSH-MA) është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj" (neni 3,

pika 17, "Përkufizime").

Bazuar në sa më sipër, gazeta "Shqip" nuk rezulton media audiovizive dhe ankesa ishte jashtë objektit të punës së AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga: **A.V**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Portale		28.09.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave iu drejtua ankuesi A.V. me pretendimin, se informacionet rreth emrit të tij, të qarkulluara si lajme në mediat online janë të pavërteta, çenojnë personalitetin, dinjitetin dhe reputacionin e tij. Ankuesi pretendonte gjithashtu, se informacionet në fjalë kishin ndikuar jetën e tij private, profesionale dhe ambientin e tij shoqëror.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi lexoi me kujdes ankesën, konstatoi se ajo u referohej portaleve, të cilat nuk janë objekt i punës së AMA-s. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Për rrjedhojë, ky ligj nuk gjen zbatim as në median e shkruar dhe as në mediat/rrjetet sociale/portalet, në raport me të cilat AMA as nuk monitoron dhe as ushtron aktivitet rregullator.

Ankesa e paraqitur nga: **R.F**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Portale**27.10.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka marrë një ankesë nga R.F., i cili i kërkonte marrjen e masave për fshirje të lajmeve dhe të dhënave të të publikuara në portale. Ankuesi pretendonte, se lajmet e publikuara rreth emrit të e tij ishin të pavërteta dhe cënonin rëndë dinjitetin dhe personalitetin e tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi lexoi me kujdes ankesën, konstatoi se ajo u referohej portaleve, të cilat nuk janë objekt i punës së AMA-s. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Për rrjedhojë, ky ligj nuk gjen zbatim as në median e shkruar dhe as në mediat/rrjetet sociale/portalet, në raport me të cilat AMA as nuk monitoron dhe as ushtron aktivitet rregullator.

Ankesa e paraqitur nga: **SH.I**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV "Klan"**Emisioni "Stop"****21.10.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Këshillit të Ankesave i ka mbërritur ankesa e SH.I., i cili ankohej për përvetësimin e një dosjeje me dokumenta nga ana e emisionit "Stop", të televizionit "Klan". Ankuesi pretendonte se dokumentat, që i ka dhënë gazetarëve të emisionit, për të kryer investigimin nuk i janë kthyer më.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, konstatoi, se ishte jashtë objektit të punës së AMA-s. Sipas ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AMA shqyrton ankesa dhe shqetësime, që lidhen me shkelje të drejtave të njeriut, të dinjitetit, etikes etj, në përmbajtje audiovizive të transmetuara. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre...".

Në rastin në fjalë nuk bëhej fjalë për përmbajtje audio apo audiovizive të transmetuar, por për një marrëdhënie me stafin e emisionit "Stop", që transmetohet në televizionin "Klan", konkretizuar në dorëzimin e një dosjeje me dokumente.

Ankesa e paraqitur nga: **A.M**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Media audiovizive dhe portale**12.11.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Këshillit të Ankesave i ka mbërritur një ankesë nga A.M, e cila pretendon se disa media dhe portale, përmes transmetimit të disa kronikave informative dhe lajmeve në mediat online, i kanë "cenuar dinjitetin njerëzor" dhe "imazhin dhe reputacionin", në shkelje të Kodit të Transmetimit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi ankesën, konstatoi se ajo u referohej portaleve, të cilat nuk janë objekt i punës së AMA-s. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Për rrjedhojë, ky ligj nuk gjen zbatim as në median e shkruar dhe as në mediat/rrjetet sociale/portalet, në raport me të cilat AMA as nuk monitoron dhe as ushtron aktivitet rregullator.

Ankesa e paraqitur nga: **Shoqëria "AGS", sh.p.k**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

RTV Ora News**Kronikë informative****12.11.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Këshillit të Ankesave i është drejtuar Shoqëria tregtare "AGS" sh.p.k, me pretendimin se "RTV Ora News", më datë 25.02.2020 kishte transmetuar disa kronika lajmesh, që kishin cenuar imazhin e kompanisë. Ankesa i referohet konkretisht kronikës me titull "Ushqimet në "Albmarket" pa datë skadence, qytetarët shprehen të pasigurtë".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi të gjithë materialin që u dërgua pranë AMA-s dhe korrespondencën e shoqërisë audiovizive "RTV Ora News". Këshilli këqyri gjithashtu me kujdes edhe materialet përkatëse filmike dhe konstatoi një raportim për sigurinë ushqimore në vend. Në lajme pretendoheshin shkelje e sigurisë ushqimore, kryesisht te datat e skadencës për disa produkte ushqimore. Në këto produkte, sipas lajmeve të transmetuara, datat e skadencës mund të fshiheshin me lehtësi, ndaj kronikat informative ngrinin shqetësimin për rrezikun e manipulimit të datave të skadencës. Më tej, në këto kronika listoheshin një sërë produktesh ushqimore, të cilave u fshiheshin lehtësisht datat e skadencës. Në fund intervistoheshin edhe qytetarët lidhur me çështjen e sigurisë ushqimore në vend.

Në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, kronikat informative mbi këtë çështje nga "RTV Ora News" ishin korrekte, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe me parimet e Kodit të Transmetimit. Në këto kronika ishte trajtuar një çështje me interes publik, siç është siguria ushqimore dhe u ishte dhënë mundësia për t'u shpre-

hur si Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) ashtu edhe kompanive prodhuese ose shpërndarëse të produkteve në fokus të kronikave, duke respektuar parimin e paanshmërisë, si detyrim i OSHMA-ve, sanksionuar nga neni 33 i ligjit nr.97/2013.

Këshilli e Ankesave konstatoi gjithashtu, se me ankesën drejtuar operatorit audioviziv, "RTV Ora News", ankuesi kishte garantuar edhe të drejtën e përgjigjes, si një prej parimeve që përcakton ligji nr.97/2013 (**Neni 4, Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, pika e).**

Sa u takonte pretendimeve të shoqërisë tregtare "AGS" sh.p.k, për respektimin e VKM-së nr.434, datë 11.07.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit" dhe Kodin e Etikës së Gazetarit, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 2 (Fusha e zbatimit), i cili përcaktohen objektin e punës së AMA-s "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre", Këshilli i Ankesave konstatoi, se ato gjendeshin jashtë jashtë këtij objekti.



Ankesa me
objekt
të ndryshëm

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Top Channel	Emisioni "Hell's Kitchen Albania"	02, 09.10.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave ka marrë dhjetëra ankesa për emisionin "Hell's Kitchen Albania", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 02.10.2020 dhe 09.10.2020 në orën 21:00. Sipas ankesave, gjatë emisionit ishte përdorur "gjuhë e papërshtatshme me fjalor vulgar dhe dhunë verbale", ka "gjuhë fyese dhe shumë e rëndë diskriminuese që shkakton bullizëm".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit "Hell's Kitchen Albania", të transmetuar në datat 2 dhe 9 Tetor 2020, duke konstatuar shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017.

Në emisionin e datës 2 Tetor, Këshilli i Ankesave evidentoi fjalor fyese dhe dhunë verbale, që, pavarësisht masave teknike të marra, mund të dëmtonin seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve.

Përdorimi i shprehjeve të tilla, si "mbylle more gojën", apo "o kokë qyp" apo dhuna verbale në komunikimin midis vetë konkurrentëve, ishte në shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton parimet themelore, sipas të cilave, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informa-

cion, bindjet politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesit dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (neni 4, pika 1, germa b).

Programi, i cili transmetohej në orën 21:00 përmbante keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe të etikës së komunikimit pa asnjë shenjë paralajmëruese, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit. Ky Kod, për programe në fashën orare 19:00-22:00 që mund të dëmtojnë fëmijët, detyron OSHMA-të të përdorin shenjë paralajmëruese, e cila shfaqet menjëherë në fillim të programit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit.

Në emisionin e datës 9 Tetor 2020, veç gjuhës së papërshtatshme të komunikimit, Këshilli i Ankesave konstatoi, se drejtuesi i emisionit diskriminonte dhe bullizonte hapur një konkurrente, duke e cilësuar atë "qorre", ndërsa konkurrentët, në disa raste gjatë emisionit, fyenin njëri-tjetrin me fjalor të rëndë, si "fëmër debile", "idiote", "inJORante", duke përcjellë imazh dhe mesazh të papranueshëm jo vetëm te të miturit.

Këshilli i Ankesave evidentoi se një gjuhë e tillë fyese dhe denigruese ishte në shkelje të normave ligjore dhe etike. Sipas ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje, që nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi", neni 32, pika 4, "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe /ose audiovizive".

Ndër parimet themelore të Kodit të Trans-

metimit, përcakton, se "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve", (pika 1.5, Seksioni 1, "Parimet themelore).

Në vijim të konstatimeve të mësipërme, Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Këshilli i Ankesave kërkoi gjithashtu marrjen e masave të duhura dhe të plota teknike për të censuruar fjalorin e papërshtatshëm, që tejkalon etikën e komunikimit dhe i kërkoi OSHMA-së marrjen e masave për vendosjen e shenjave paralajmëruese, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit në pikën 5.48 të tij.

Fund

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.
www.ama.gov.al

këtej, mbështetur në Kodin
të miratuar nga A
e Audiovizive i cili përm
parimet, rregullat, kërkes
e transmetimeve audioviz
ën e Shqipërisë, Këshilli i
n të vëzhgojë me kujdes se
të mirëpërcaktuara për p
tëmet audiovizive zbatoh
i Këshillit të Ankesave i
kohësh ka qenë i mundur
audioviziv si këshillues i pë
meve audiovizive, është n
të cilin raportohen resul
vara nëpërmjet të cilave dy
parimet, rregullat, kërkesat